



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KRYETARI

Nr. 718/1 Prot.

Shkodër, më 23/12 / 2024

Vendim

Nr. 27, Datë 20/12/2024

“Për miratimin e Strukturës Organizative, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe struktura organizative e DAMT-së, për vitin 2025”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 20.12.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “Për miratimin e Strukturës Organizative, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe struktura organizative e DAMT-së, për vitin 2025”, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 8, pika 2) dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 ‘Për Nëpunësin Civil’ (i ndryshuar); Ligjin Nr.7961, Datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë ” (i ndryshuar); VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.503 datë 01.08.2024, VKM, nr. 326, datë 31.05.2023, ndryshuar me VKM nr 422, datë 26.06.2024, Ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi”, Vendimin Nr. 142, Datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar, ligjit

r.9244, datë 17.06.2004, "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore", i ndryshuar, VKM Nr.80 datë 11.01.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore", VKM nr. 121, datë 17.02.2011, "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga DAMT në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunat dhe bashki", Ligjin Nr. ____/ 2024, "Për buxhetin e Vitit 2025", Buxhetin e vitit 2025, në funksion të realizimit të përgjegjësiave ligjore të administratës të KQSH-së, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u **miratua** me **17 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim**;

VENDOSI:

1. Të miratojë Strukturën Organizative, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, me gjithsejt 13 (trembëdhjetë) punonjës, 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ, sipas tabelës bashkangjitur.
2. Burimet financiare do jenë transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2025.
3. Të miratojë strukturën e punonjësve të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, funksion i deleguar pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, sipas tabelës bashkangjitur.
4. Burimet financiare do jenë transferta e kushtëzuar sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2025 për këtë funksion.
5. Efektet financiare do të fillojnë nga Data 01.01.2025.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

